

Kultura dhe sporti në Komunën e Prishtinës



RAPORTI 2016

**Prishtina
po bëhet**



Gjatë periudhës trevjeçare fokusi i qeverisjes sonë ka qenë në zhvillimin e kulturës dhe sportit, përmes përkrahjes dhe promovimit të artistëve dhe sportistëve. Qasja e barabartë dhe e drejtë në fondet e Komunës për kulturë dhe sport për të gjithë artistët dhe sportistët, ka krijuar mundësi për promovimin e kulturës dhe sportit, e sidomos të artistëve dhe sportistëve të rinjë.

Qasje të barabartë dhe të drejtë në fondet e Komunës për kulturë dhe sport



Për të ndihmuar zhvillimin e kulturës dhe sportit nuk mjafton ndërtimi i infrastrukturës, nëse nuk përcillet me përkrahje me fonde të artistëve dhe sportistëve. Duke e ditur se buxheti i Komunës së Prishtinës është shumë i vogël dhe nuk mjafton për të realizuar projekte të mëdha kapitale, në fushën e kulturës dhe sportit jemi fokusuar më shumë në përkrahjen direkte të artistëve dhe sportistëve. Përkrahjen direkte kemi arritur ta bëjmë përmes dyfishimit të subveconeve në zhvillim të kulturës dhe sportit.

Përkrahja e drejtë dhe transparente mund të realizohej vetëm me ndryshimin e kriterëve dhe procedurave për ndarjen e subvencioneve, të cilat i ndryshuam qysh në fillim të mandatit. Përpilua kriterë dhe procedura, përmes të cilave kërkesat e të gjithë artistëve dhe sportistëve trajtohen në mënyrë të drejtë dhe ndahen në bazë meritore përmes një komisioni të pavarur. Komisioni i pavarur përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët dy janë nga drejtoria përkatëse dhe tre nga shoqëria civile apo ekspertë të jashtëm.

Subvencionet në zhvillimin e kulturës

Subvencionet në zhvillimin e kulturës

Gjatë periudhës 2014-2015, për zhvillimin e kulturës janë ndarë subvencione në shumën 528,037.00 euro. Në vitin 2016 janë ndarë 260,000.00 euro, ndërsa për vitin 2017 janë planifikuar 260,000.00 euro.

Përmes subvencioneve janë përkrahur institucionet komunale kulturore: Teatri i kukullave "Dodona", Qendra; institucionet e pavarura kulturore, festivale dhe manifestime të ndryshme, botime të librave, arte vizuale, muzikë, film dhe teatër.

Subvencionet në zhvillimin e sportit

Gjatë periudhës 2014-2015, në kuadër të zhvillimit të sportit janë ndarë subvencione në shumën 405,585.00 euro. Në vitin 2016 janë ndarë 256,000.00 euro, ndërsa për vitin 2017 janë planifikuar 300,000.00 euro.

Përmes subvencioneve janë përkrahur projekte të ndryshme të sportit, klubet sportive të qytetit dhe projekte të rinisë.

Investimet në infrastrukturë të objekteve kulturore dhe sportive



Biblioteka "Hivzi Sylejmani"

Në gusht të vitit 2016, u përrua objekti i ri i bibliotekës "Hivzi Sylejmani", projekt ky që kishte filluar pesë vite më parë. Objekti është i pajisur me 400.000 ekzemplarë, të fushave të ndryshme, me interes për lexuesit.

Investime Kapitale në kënde të lojërave për fëmijë dhe fitnes për të rritur

Përgjatë këtyre viteve në Prishtinë ka pasur gjithmonë mungesë të këndëve të lodrave në lagje të ndryshme. Me qeverisjen tonë kjo gjë ka ndryshuar. Kemi ndërtuar këndet të lodrave për fëmijë dhe fitnes për të rriturit në hapësira të lëna pas dore, duke i kthyer ato në vende atraktive për fëmijë dhe të rinjë. Investimet me kënde të lodrave dhe fitnes, janë në përfundim e sipër në lagjet: "Kalabria", "Kodra e Trimave", "Bregu i Diellit".

Organizimi i koncerteve dhe manifestimeve të tjera

Komuna e Prishtinës ka për qëllim që të gjallërojë jetën kulturore, duke ftuar në Prishtinë artistë të njohur në vend dhe nga jashtë.

Në gusht të vitit 2016, Komuna e Prishtinës organizoi përherë të parë, koncertin madhështor të Dua Lipës në Prishtinë, i cili u ndoq nga më shumë se 20,000.00 adhurues. Në shtator 2015, u organizua koncerti me jazz kompozitoren dhe këngëtare shqiptaro-zvicerane me famë ndërkombëtare, Elina Duni, ku prezantoi albumin e saj "Dallëndyshe".

Në qershor 2015, u organizua koncerti i kantautorit shqiptar, Alban Skenderaj, në amfiteatrin e parkut Gërmia, në Prishtinë, i cili u ndoq nga qindra adhurues të muzikës.

Festa e Muzikës – Dita Ndërkombëtare e Muzikës

Tashmë organizim tradicional, që u organizuar për tri vjet radhazi nga Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me Ambasadën e Francës, Aleancën Franceze dhe me Filarmoninë e Kosovës, me pjesëmarrje të zhanreve të ndryshme muzikore, artistë profesionistë dhe amatorë, të huaj dhe vendas.

1 Qershor – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve

Në kuadër të projektit "Prishtina Lexon", përmes të cilit synojmë të nxisim dëshirën për lexim dhe të krijojmë shprehje të leximit, për tri vjet radhazi kemi organizuar kampanjën e leximit "Prishtina Lexon" dhe garat: "Përralla më e mirë për Prishtinën", "Novela më e mirë grafike", dhe "Lexuesi më i mirë veror".

Dita Ndërkombëtare e Librit

Me rastin e 23 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Librit, Sektori për Rini i Komunës së Prishtinës, organizoi debat me të rinjtë e Komunës së Prishtinës, me temën "Libri dhe kultura e leximit".

Dita ndërkombëtare e rinisë

Me rastin e 12 Gushtit, Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, Sektori i Rinisë i Komunës së Prishtinës organizoi aktivitete të ndryshme. Aktivitetet u mbajtën në sheshin "Zahir Pajaziti" dhe në pishinën e Gërmisë. Në sheshin "Zahir Pajaziti" u organizuan këto aktivitete: Këndi i pikturës, Simulimi i ndihmës së parë, Aktivitete të Parkourit – Shoë Parkour dhe aktivitet motoristike, kurse në pishinën e Gërmisë: bianale grafike – aktivitete artistike me sprej (ngjyrë për metal), aktivitete në not për fillestar dhe gara noti për të rinjë, siguria në komunitet – ligjëratë, futboll, lojëra pa kufi dhe turneu në basketboll.

Organizimi i aktivitetit "Turnament i debatit", së bashku me organizatën ndërkombëtare "Save the Children", me rastin e shënimit të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit, u organizua edhe trajnimi i përgjithshëm mbi rregullat dhe teknikat e formatit të debatit "Karl Popper". Debatit kishte karakter garues, ku pjesëmarrës ishin fëmijët e Asamblesë Komonale të Prishtinës, Ambasadorët e Rinj të Qendrës Kulturore të Fëmijëve, si dhe fëmijët e Grupit "ROR". Debatit final u mbajt me 7 mars 2016, në degën "Përkujtimorja" në Taukbaççe të Bibliotekës "Hivzi Sylejmani". Tema finale e debatit ishte "Mësimdhënësit nuk duhet të kenë të drejtën e grevës", ku dhe fitues të këtij debati ishin grupi Fëmijëve pjesëmarrës nga Asambleja.





Dita Ndërkombëtare e Poezisë – u organizua programi festiv, bashkë me Drejtorinë e Arsimit. Programi u mbajt në shkollën "MODEL", ku përveç programit festiv, u bë edhe interpretimi i poezive më të mira të përzgjedhura nga komisioni vlerësues.

Organizimi i Ditës Ndërkombëtare të Familjes së bashku me "Save the Children" dhe Asamblenë Komunale të Fëmijëve të Prishtinës. Ky aktivitet u shënuar për herë të dytë. Qëllimi i shënimit të kësaj dite është promovimi i familjes dhe vlerave të saj, nxitja e barazisë midis figurave të dy prindërve, mbrojtja e familjes si bazë e shoqërisë.

Organizimi i aktiviteteve sportive

Dita kombëtare e Flamurit - 28 Nëntor

Për shënimin e kësaj dite janë zhvilluar aktivitete të ndryshme, si turneu në basketboll dhe futboll me shkollat e mesme të kryeqytetit, organizuar nga Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit. Finalet e këtyre dy turneve u mbajtën në shkollën fillore "Model" dhe fitues ishin SHM "Ahmet Gashi" si në futboll, ashtu edhe në basketboll.

Turne në basketboll me shkollat e basketbollit – organizuar nga Shoqata e Mini basketbollit të Kosovës, turne ky i cili u mbajt në shkollën fillore "Ismajl Qemali", ku pjesëmarrës ishin shkolla të basketbollit të qyteteve të ndryshme të Kosovës, dhe fitues doli shkolla e basketbollit nga Podujeva.

Turneu i shahut për të shurdhër -

Organizuar nga Shoqata e të Shurdhërve të Prishtinës, projekt ky i mbështetur financiarisht nga Komuna e Prishtinës. Pjesëmarrës ishin shahistë të kësaj kategorie nga qytetet e ndryshme të Kosovës.

Turneu ndërkombëtarë i boksit "Adem Jashari", organizuar nga Federata e Boksit të Kosovës, në bashkëorganizim me Komunën e Prishtinës, për nder të 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit.

Aktivitete të ndryshme sportive të shkollave fillore dhe të mesme – organizuar nga Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit të Prishtinës përgjatë vitit 2016.



Prishtina
po bëhet